



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.1

Qershor 2024

PËLHURAT TREGOJNË HISTORI TË NDRYSHME: NJË ALEGORI ILUMINISTE NË NJË VESHJE TRADIËIONALE SHKODRANE

Dorina Arapi*

**Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike,
Albanian University*

Veshjet tradicionale dhe pëlthurat me të cilat janë realizuar këto veshje janë një dëshmi e kontakteve e konflikteve kulturore të një shoqërie. Në periudhën paraindustriale, veshja tradicionale e lokale ishte e lidhur ngushtë me politikat e kohës, me kulturën, ekonominë, traditat lokale dhe me institucione të ndryshme vendore. Duke qenë se pjesa e jashtme e veshjes, diktohej nga politikat e kohës, pjesa e jashtme ka marrë gjithnjë një rëndësi të madhe studimore. Por me aq rëndësi sa pjesa e jashtme e veshjes, pjesa e brendshme e saj, astari, mund të zbulojë po aq aspekte thelbësore sa pjesa që duket. Analizimi i pëlthurave të astarit, mund ti ofrojë analizës historike dhe antropologjike të veshjes, këndvështrime të tjera. Kjo analizë mund të jetë një element kyç në rindërtimin e kohës së prodhimit të veshjes apo të jetë një dëshmi e rëndësishme e marrëdhënieve ekonomike, politike, kulturore të kohës, dhe po aq të flasë për bartësin dhe statusin ekonomik, kulturor e shoqëror të tij. Gjuha vizuale e motiveve, alegorive të stampuara apo të qëndisura nëtë, ofrojnë këndvështrime të tjera historike dhe kulturore që shkojnë paralelisht me pjesën e jashtme të veshjes. Duke i vendosur ato në një plan krahasues, pjesa jashtme dhe ajo e brendshme e një veshjeje, tregojnë një histori të ndryshme.

Gjatë periudhës së sundimit osman, pozicioni gjeografik i asaj që njohim sot si Shqipëria politike, ishte pothuajse periferik në raport me qendrën e Perandorisë Osmane, Stambollin, e vendoste atë në pozitat e një territori në kufi të perandorisë e në përballje konstante me botën perëndimore. Të qenit në kufi të shtetit osman, por dhe një territor ku shënjohej forca e perandorisë përballë vendeve të Adriatikut, bëri që trevat e qytetet shqiptare të shërbenin e të ishin si ‘toka të mesit’ e si urë lidhëse midis dy botëve. Qytete si Shkodra apo Vlora, të cilat ishin të lidhura me qytetet italiane, u konsideruan si porta lidhëse midis perëndimit e lindjes, me një natyrë borderland, duke i dhënë një frymë ndryshe kulturës materiale.

Termi borderland (tokë kufiri), nuk tregon një vendndodhje topografike të qëndrueshme midis dy kulturave e shoqërive, por një zone ndërmjetëse që zhvendoset dhe deterritorializim që i jep formë subjektivit të hibridizuar.¹ Rasti i qyteteve porteve osmane si Shkodra, të cilat në tërësi nuk ishin as “europiane” dhe as “qytete të modelit islamik”, funksiononin si “toka të mesit” midis osmanëve dhe europianëve.²

1 Onur Inal, ‘Women’s Fashions in Transition: Ottoman Borderlands and the Anglo-Ottoman Exchange of Costumes’, në Constanta Vintilă-Ghinulescu (Ed.), *From Traditional Attire to Modern Dress: Modes of Identification, Modes of Recognition in the Balkans (XVIth - XXth Centuries)*, Cambridge Scholars Publishing, 2011, 18.

2 Inal, ‘Women’s Fashions’, 148.

Në këtë prizëm Shkodra, ndahej midis kulturës përtej Adriatikut dhe asaj islamike, një kulturë e hibridizuar ndërmjet dy botëkuptime të ndryshme, si veshja e gruas katolike, ashtu dhe stolisja e saj që dëshmojnë këtë dyjëzim kulturor.³ Ky qytet ishte sa ‘venedikas’ në kulturë, po aq dhe osman administrativisht, pra kulturalisht heterogjen, si zonë ndërvepruese, në proces marrjeje e dhënie. Këto hapësira ndërveprimi u shtuan më së tepërmi gjatë shekujve XVIII-XIX, ku dhe qytetet-porte shqiptare patën kontakte të shpeshta me vendet e Europës e të Lindjes. Kjo favorizoi tregtinë, shkëmbimin e mallrave, shumëllojshmërinë e tyre, por dhe krijoi hapësira e territore të veprimit midis tyre.

Mallrat e industrisë evropiane, si dhe mallrat që vinin nga vende të perandorisë osmane kanë qenë prezent në kulturën e konsumit të qyteteve shqiptare gjatë sundimit osman.

Në shekullin XVI në qytetin e Vlorës hynin artikuj e tekstile që vinin nga Bursa e Stambolli.⁴ Në Vlorë hynin mallra të kushtueshëm që vinin nga portet e perandorisë. Nën kontrollin e osmanëve vazhduan të ruhen marrëdhëniet tregtare me qytetet italiane, si në rastin e tregtarëve florentinë, që vazhdonin tregtinë e tyre në Vlorë, si importi i mallrave nga Venediku, ashtu dhe eksporti i leshit dhe i mëndafshit drejt qyteteve italiane.⁵ Në qytetin e Vlorës hynin artikuj e tekstile që vinin nga Bursa e Stambolli, si kemha, stofra, tafta, vale, tylbend, bogas, astar, beze, mahrama etj., të cilat duke mos qenë prodhime vendase hynë në treg së bashku me emërtimet e tyre, ashtu siç gjendeshin në tregjet turke.⁶

Gjatë shekujve XVII- XVIII nën ndikimin e kulturës osmane të konsumit, nga të dhënat arkivore vërehet se veshjet e kohës qepeshin me pëlhura të ndryshme, si allaxha, kemha, kumash, çatma, hatai etj. Kështu për shembull, në një akt gjykatë të vitit 1678, dy tregtarë nga Berati, të cilët kishin një shoqëri me emrin “Shoqëria osmane” kishin shkëmbime tregtare me një tregtar veneçian, Mikel Floro dom Baroni. Dy tregtarët nga Berati blinin mallra në Venedik dhe i shisnin ato në qytet.⁷

Në një rast tjetër, në një akt trashëgimie të vitit 1751,⁸ rezultojnë veshje të qepura me pëlhura të ndryshme, si shahmeran (Şahmeran, një pëlhurë me figurë të stilizuar gjysmë femër gjysmë gjarpër, e cila përdorej gjerësisht si motiv qëndisime në tekstilet orientale)⁹, diba (dibâ - një pëlhurë mëndafshi e punuar rëndë), basra (basra, pëlhurë që prodhohej nga Basra në Irak), kadife, hatai (hatayî), hatai e dorës së parë dhe prej cohës. Disa prej tyre ende ruhen në kujtesën shoqërore e në fjalorin e bartësve.

Gjatë shekujve XVII-XVIII, bazuar në burimet arkivore, veshjet e kohës, si kaftanët, qepeshin me pëlhura të ndryshme si: kaftan prej allaxhaje (kaftan alacası), prej hareje (hare), kemha (kemha), kemhaja ishte një mëndafsh shumëngjyrësh dhe i thurur me fije ari metalike; atlas, kumash, pëlhurë mëndafshi e shkëlqyeshme, si stofra përgjithësisht (kumaş),¹⁰ çatma (çatma) një lloj kadifeje e shtrenjtë e thurur me fije ari dhe argjendi; diba (dibâ) mëndafsh i rëndë; hatai (hatay hatayî), kjo pëlhurë e kishte marrë emrin nga zona Hatai, në Anadoll të Turqisë, aty ku prodhohej.¹¹

3 Dorina Arapi, Shkodra, *Një dëshmi e konvergimit kulturor në panoramën e mes shekullit XIX*, Univers 21 (21), Tiranë, IIATC, 117-22.

4 Shih: *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë. Shqipëria nën sundimin feudal-ushtarak osman (1506- 1839)*, Vëll III, Universiteti Shtetëror i Tiranë, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1962.

5 Zija Shkodra, *Esnafet shqiptare (shekujt XV-XX)*, Akademia e Shkenësive e Shqipërisë. Instituti i Historisë, Tiranë, 1973, 38; Surayia Faroqi, *Textile Production in Rumeli and the Arab Provinces: Geographical Distribution and Internal Trade (1560-1650)*, Osmanlı Araştırmaları. The Journal of Ottoman Studies, Stamboll, I (1980), 61-83.

6 *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë*, 1962.

7 ASHQ, Fondi 128, Dosja 16, fl. 38, viti 1678.

8 Në një akt trashëgimie të vitit 1751, Sulejman pashë Elbasani martohet me Rukije Hanëmin, bijën e Mahmut Pashës nga Velabishti. AQSH, Fondi 128, dosja 5, fl. 30, Viti 1751.

9 Michael Hann, *Symbol, Pattern and Symmetry: The Cultural Significance of Structure*, Bloomsbury Academic, 2013, 189.

10 Pëlhurë mëndafshi, shih: Tahir N. Dizdari, *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Instituti Shqiptar i mendimit dhe i qytetërimit Islam, Tiranë, 2005.

11 Amanda Philips, *The historiography of Ottoman velvets, 2011-1572: scholars, craftsmen,*

Fundi i shekullit XIX shënon një lëvizje të gjerë e larmi të mallrave të importuara apo të eksportuara, ashtu siç shohim të dokumentuara tekstile të ndryshme, si pëlhurë selimije, copë damaskine,¹² tekstil politiko a një lloj materiali i fabrikuar, që mund të ishte shami i prodhuar në Konstandinopojë ose i printuar me dizajn konstandinopojan,¹³ si dhe copa meksikane, laxhivërd i kuq nga Ankaraja (Laëivert kırmızı Engürü),¹⁴ beze amerikane (Amerikan bezi), një lloj beze (Hümayün bezi), Şam alacası, kalikot (calicot), i cili merr emrin nga qyteti i Calicùt në Malabar dhe ishte një pëlhurë e lehtë pambuku të papërpunuar, më i hollë se percallo (percale),¹⁵ tafta, copa të kuqërremta e të kuqe krimzon me formë Dame..... sipas modës (pezzi scarlati e rossi cremeson righe a Damaalla Moda), Londrin menevis, deffilato cremeson, deffilato scarlatto, por dhe eksportim dhe importim të copave damask (topa damascha) pëlhurë selimije ngjyrë limoni.¹⁶ Tekstilet me shirita të njohura si alaca ose medeniye (me shirita të kuq të cilësive të ndryshme) dhe kutnu (shirita mëndafshi të thurura me model dhe ikat), përpunoheshin në varietete të ndryshme ngjyrash dhe modelesh, ku më të përhapurat ishin e kuqja, e verdha e artë dhe e zeza.¹⁷ Allaxhaja mbetet një nga pëlhurat, nga shekujt e vonë të mesjetës e deri në shekullin XX, si një nga më të përdorurat në veshjet tradicionale në Shqipëri. Në fund të shek. XIX, shallvaret shiteshin prej tekstileve të ndryshme si shallvare laxhivërd (një lloj pëlhurë e përdorur për shallvare), shallvare prej basme, prej marhamaje, xhanfezi, si dhe importoheshin dila, allaxha, pëlhura nga Viena, puplinë, xhanfes, bezra Indiye e shumë stofra që emërtoheshin si mallra të ardhur nga India.¹⁸

Krahas kontakteve tregtare, vrull të madh kishin marrë edhe lidhjet kulturore e arsimore me vendet e ndryshme europiane, veçanërisht me Italinë, Austrinë, Francën etj. Tregtarët e mesëm e të pasur kishin ngritur agjenci tregtare që funksiononin rregullisht. Tregtarët e Durrësit e të Vlorës kishin agjentë të tyre që merreshin me importimin e këtyre mallrave. Në vitet '20 e '30 të shekullit XX, tregtia e Vlorës dhe e Durrësit arrinte të furnizonte disa qytete të Shqipërisë. Tregtarët e Beratit furnizoheshin me mallra të ndryshëm që vinin jo vetëm nga Europa, veçanërisht nga Venediku, por dhe nga mallrat e Lindjes, si Damasku (Siri), Iraku, veçanërisht India e Japonia. Shumë pëlhura të prodhuara në Japoni, si tekstilet Yo-Yo, Drilis Japonais, Satin Kanebo, Cabots japonais T'cloth, Madapolam japonais, importoheshin nga firma tregtare Zahara.¹⁹ Mallrat japonezë vinin nga Aleksandria, kalonin në Selanik e më pas në Korçë, prej nga më pas shpërndaheshin nëpër qytete të tjera.

“Dritë dhe errësirë”: Alegoria iluministe

Gjatë shekujve XVIII-XIX, veshja tradicionale e komunitetit katolik në Shkodër ishte ngushtësisht e lidhur me rregullat e normat që kishte shoqëria shkodrane. Veshja duke qenë shenjë e statusit social dhe atij ekonomik ishte edhe subjekt i ndalesave, rregullave të vendosura nga komuniteti

consumers, Journal of Art Historiography, 6 (2012).

12 AQSH, Fondi 143, Dosja 2271, fl.16.

13 Shih: Angeliki Hatzimichali, *The Greek Folk Costume*, Vol.2, Benaki Museum, Melissa Publishing House, Athens, 1984, 453.

14 Dizdari e përshkruan si gur i çmueshëm ngjyrë bojë qielli, fjalë që vjen nga turqishtja Lacivert (pers. Laxhevërd), shih: Dizdari, *Fjalor i orientalizmave*, 581.

15 Fjalori Treccani, <http://www.treccani.it/vocabolario/percallo/>; Andromaqi Gjergji shkruan se perkallina, ishte një pëlhurë e zezë e shkëlqyeshme që importoheshin nga Venediku, shih: Gjergji, *Veshje shqiptare*, 158.

16 Për këto të dhëna janë konsultuar fondet, AQSH, Fondi 143, Dosja 2271, fl. 76; AQSH, Fondi 143, Dosja 2271, fl. 20.

17 Condra, Jill. *Encyclopedia of National Dress: Traditional Clothing Around the World* [2 Volumes]. Mbretëria e Bashkuar: Bloomsbury Academic, 2013, 733.

18 AQSH, Fondi 130, Dosja 240, fl. 148; AQSH, Fondi 130, Dosja 240, fl. 7.

19 AQSH, Fondi 95, Dosja 135, fl. 4, viti 1937/ Dosja 77, viti 1932.

katolik, institucionet fetare dhe shteti.²⁰ Për këtë arsye, pjesa e jashtme e veshjes ishte një pasqyrim i marrëdhënies që bartësi krijonte me statusin shoqëror të tij dhe rregullat komunitare.

Ndryshe nga dukja, pra nga pjesa e jashtme e veshjes, pjesa e brendshme (astari), rrallë herë është trajtuar si pjesë e rëndësishme e kritereve të vendosura nga shoqëria dhe institucionet e kohës. Këtë gjë e hasim vetëm një herë në një ndalesë të shpallur në vitin 1852, ku astari cilësohej të ishte prej basme pambuku dhe jo cope allaxha.²¹

Në këtë artikull, do të analizojmë në linja të përgjithshme, një pëlhurë pambuku e përdorur si astari i brendshëm e një xhybeje të veshjes së gruas katolike shkodrane.²²

Astari i kësaj xhybe është prej një pëlhurë pambuku, që me gjasa mund të jetë një kaliko, një lloj pambuku mjaft i përdorur nga shekulli XVII e deri XIX në Europë. Përdorimi dhe konsumi i kalikos nga shtesa të ndryshme dhe në masë të gjerë, solli dhe që shtete si Anglia e Franca të shpallnin akte ndalese mbi prodhimin e kalikos.²³ Këto pëlhura pambuku stampoheshin nëpërmjet teknikës së gravurës, me matricë druri, si edhe metali, bakri. Kjo teknikë vjen nga baza e teknikave të gravurës të stampës mbi letër, ndryshe e njohur si kalkografia.

Teknikat e kalkografisë, të cilat synojnë të inçizojnë linja në sipërfaqen e drurit apo metalit, realizohen me mjete të ndryshme. Inçizioni i realizuar në matricë bakri që gërryhet nëpërmjet acidit, siç për shembull akuaforti, krijojnë gërvishtjen që lyhen me bojë e më pas stampohet mbi letër. Kjo procedurë, e cila ishte një teknikë artistike, ishte dhe baza e dekorimit të pëlhurave të pambukut në këtë periudhë. Por nuk mbetet vetëm kjo. Matrica për dekorin, mund të ishte edhe prej druri. Kjo është teknika e ksilografisë, e cila është e njëjtë si koncept me akuafortin, por në rastin e ksilografisë, nuk përdoret acidi për të krijuar incizime, por gdhendet me dalta specifike.

Kultura e stampës, grafikës së shtypit, e cila dominoi gjatë shekujve XVI-XVIII, ndihmoi e favorizoi përhapjen e qarkullimit të imazheve dhe shumëfishimit të tyre. Këto teknika të dekorimit të pëlhurave favorizuan krijimin dhe përcjelljen e imazheve të reja herë pas here. Kështu për shembull është rasti i pëlhurës mjaft të përhapur të asaj kohe Toile de Jouy, ku artistët paraqisnin ngjarjet politike dhe kulturore më domethënëse të kohës, duke përmbushur edhe nevojat e konsumatorit.²⁴ Këto pëlhura u përdorën si në veshje, ashtu dhe për mobilje e objekte të tjera interieri.

Në astarin e xhybes, të cilën kemi marrë në analizë, paraqiten motive floreale rokoko,²⁵ si dhe një imazh i përbërë prej një shandani qirinjsh dhe sistemi diellor. Kjo është një alegori, ku imazhet e vendosura në të janë të organizuara për të përcjellë një mesazh simbolik e politik të shekullit XVIII. Në qendër të sistemit diellor, paraqitet dielli që lëshon rrezet e tij, dhe anash tij qëndrojnë 6 planetë. Kjo është e dhëna fillestare për prodhimin e pëlhurës. Dizajneri ka paraqitur 6 planetë: Tokën, Mërkurin, Venusin, Marsin, Jupiterin e Saturnin. Fakti që paraqiten vetëm këto planetë tregon

20 Dorina Arapi, *Ndikimet orientale ne veshjet popullore shqiptare*, tezë doktrature, <https://drive.google.com/file/d/0Bz1NpApIa1A6MGUzRDZMRVNQbk0/vie?resourcekey=0-5o4E4nOV4eMRqKPTiTZh0g>, 2017; “Women’s Traditional Dress in Ottoman Shkodër. The Case of the Catholic Community through Archival Documents of Archdiocese of Shkodër (18th -19th century)”, në Forum A+P nr. 19, Universiteti Polis, Tiranë.

21 Arapi, *Ndikimet orientale ne veshjet popullore shqiptare*, 2017.

22 Kjo xhybe është pjesë e fondit etnografik të Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit në Tiranë.

23 Baghdiantz McCabe, Ina. *Orientalism in Early Modern France: Eurasian Trade, Exoticism, and the Ancien Régime*. Mbretëria e Bashkuar: Bloomsbury Publishing, 2008.

24 Riffel, Melanie., Rouard, Sophie. *Toile de Jouy: Printed Textiles in the Classic French Style*. Mbretëria e Bashkuar: WW Norton, 2003; Bogansky, Amy Elizabeth. *Interwoven Globe: The Worldwide Textile Trade, 1500-1800*. Norvegji: Metropolitan Museum of Art, 2013.

25 Rokoko (Roccoco), është një rrymë artistike e shek. XVIII, e cila dallohet për format tepër dekorative dhe ngjyrat pastel.

se planeti i shtatë ende nuk ishte zbuluar në kohën që është stampuar pëlatura. Pra pëlatura është prodhuar para vitit 1781, vit që përkon me zbulimin e planetit Uran.

Por ajo që tërheq përveç datimit të kësaj pëlature, në bazë të analizës vizuale, është alegoria që krijohet me dy imazhet, shandanin e qirinjve dhe sistemin diellor. Kjo alegori, për vetë kohën që është prodhuar pëlatura, por mbi të gjitha për mesazhin që përcjell është një alegori iluministe.

Iluminizmi ishte një lëvizje kulturore e shekullit XVIII, ku intelektualë, shkencëtarë, filozofë udhëhoqën me idetë e tyre drejt një qasjeje të re ndaj mendimit dhe botës. Iluministët në filozofinë e tyre kishin si qëllim, të çliruar nga kufizimet e doktrinës fetare, që me fuqinë e arsyes, djes e shkencës të reformonin mendimin e shoqërinë. Lëvizja iluministe e ndau shoqërinë nga “periudha e errët e paditurisë” për ta udhëzuar atë drejt dritës së arsyes e shkencës.²⁶

Alegoria e paraqitur në pëlaturë është një paraqitje vizuale, ku në mënyrë dikotomike, paraqitet periudha e errët e paditurisë që simbolizohet nga shandani me qirinj, por udhëhequr nga arsyeja e shkenca që simbolizohet pikërisht nga diagrama e sistemit diellor.²⁷ Shekulli XVIII shënon mjaft zbulime shkencore, dhe veçanërisht në fushën e fizikës. Isaak Njuton (1642-1727) në librin e tij *Principia Mathematica* (1687) integroi idetë e Kopernikut, Keplerit dhe Galileut në një sistem të ligjeve matematikore për të shpjeguar mënyrën e rregullt në të cilën planetët rrotulloheshin rreth diellit.²⁸ Ajo që ishte kryesore në tezën e tij ishte ligji i gravitetit universal. Sipas këtij ligji, në univers çdo trup tërheq një tjetër në marrëdhënie të sakta matematikore, materia ushtron një forcë, gravitetin, që tërheq të gjithë trupat e tjerë drejt qendrës së saj. Ligji i Njutonit vërtetoi se universi funksiononte nga rregulla që mund të shpjegoheshin përmes fizikës dhe jo më tashmë me një interpretim fetar. Me këtë ligj, Njutoni përforcoi akoma më shumë vlefshmërinë e modelit heliocentrik të sistemit diellor, duke argumentuar se ishte Dielli dhe jo Toka, në qendër të sistemit diellor.

Po të vërejmë alegorinë, sistemi diellor dominon mbi figurën e shandanit. Dielli është paraqitur si trupi më i madh qiellor, i cili ushtron gravitet tek planetët. Rrezet e tij dominojnë në imazh “duke ndriçuar botën” e duke “shuar” kështu epokën e errësirës. Rrezet e diellit, metaforikisht, përhapin dritën e arsyes kundrejt errësirës të një bote që tashmë kishte përfunduar. Skena e rrethuar me motive floreale rokoko, si dhe e trajtuar me tone pastel dhe me raporte të së kuqes dhe jeshiles, vërteton akoma më shumë në përcaktimin e një stili specifik artistik dhe me shekullin XVIII.

Konkluzione

Pas kësaj analize ikonografike e vizuale, mund të themi se pëlatura e astarit daton para pëlatura është prodhuar para vitit 1781, vit që përkon me zbulimin e planetit Uran.

Kjo analizë, si dhe zbulimi i datimit të pëlaturës, ndihmon për të përcaktuar dhe një datim më të saktë të xhybes. Ndoshta mund të themi se edhe xhybja është prodhuar në të njëjtën periudhë me pëlaturën e astarit?

Studiuesit shqiptarë kanë shkruar se objektet në fondet etnografike të muzeve dhe institucioneve shqiptare, nuk datojnë më herët se gjysma e dytë e shekullit XIX. Duke pasur parasysh se këto pëlatura ishin në modë, familjet e pasura katolike shkodrane, arrinin të blinin mallra të kushtueshëm të kohës. Gjithashtu Shkodra, kishte qenë një qytet, i cili kishte ruajtur marrëdhëniet kulturore e ekonomike me vendet perëndimore dhe kjo pëlaturë është dëshmi e kontekstit kulturor dhe natyrës hibride kulturore.

Në këtë prizëm, nëpërmjet kësaj analize të këtij artefakti, kuptojmë se shfaqen dy botëkuptime të ndryshme të cilat ecin paralelisht me njëra-tjetrën: pjesa e jashtme e veshjes, ajo që duket, e cila ruan

26 Wilson, Ellen Judy., Reill, Peter Hanns. *Encyclopedia of the Enlightenment: Facts On File, Incorporated*, 2014.

27 Për ikonografinë e Iluminizmit shih: Rolf Reichardt dhe Deborah Louise Cohen, *Light against Darkness: The Visual Representations of a Central Enlightenment Concept*, 1998.

28 Christianson, Gale E.. *Isaac Newton: And the Scientific Revolution*. United States: Oxford University Press, USA, 1996.

dhe reflekton statusin e bartësit që ishte subjekt i rregullave të politikave të kohës, që zbatoheshin dhe monitoroheshin nga komuniteti katolik, dhe pjesa e brendshme, ajo që nuk dukej, dhe ishte e fshehtë, ishte një hapësirë e lirë për të përzgjedhur sipas dëshirës së bartësit një produkt që ishte jashtë rregullave të kontekstit politik, ekonomik e shoqëror i komunitetit katolik shkodran.



Figura 1. Pëlhura e astarit në xhyben e gruas katolike shkodrane




Figura 2. Skicë e alegorisë së paraqitur në pëlhurë